

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARTAN BAJRAMI

02/14/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 13.02.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Bajrami, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 14.02.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Artan Bajrami, drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Valbona Sanxhaktari, znj. Suela Zhegu relatores, znj. Brunilda Bektoshi anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve .

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.